



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 14.09.2011

Nr. i rastit: 2011-10

Dejan Jovanovic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 shtator 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Vergina MICHEVA-RUSEVA, anëtare zëvendësuese

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 14 prill 2011.
2. Kjo ankesë lidhet me procedurat pranë Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (më tutje: DhVGjS). Znj. Bednarek është anëtare e Panelit dhe gjithashtu gjykatëse e EULEX-it, e cila punon në DhVGjS. Prandaj znj. Bednarek nuk mund të merr pjesë në

shqyrtimin e këtij rasti si anëtare e Panelit. Ajo është zëvendësuar nga znj. Micheva-Ruseva, e cila është anëtare zëvendësuese.

II. FAKTET

Informata

3. Ankesa ka të bëjë me një kontest rreth të drejtave pronësore në komunën e Graçanicës. Parashtruesi i ankesës dhe të afërmit e tij janë bashkë-pronarë të tokës në fjalë.
4. Në vitin 1936 Gjykata Bujqësore e Graçanicës kishte bartur pronësinë tokës në fjalë tek gjyshi i parashtruesit të ankesës. Në atë kohë pronësia e të afërmeve të parashtruesit të ankesës nuk ishte kontestuar.
5. Në vitin 1953 Komisioni i Qarkut për fondin e tokës bujqësore, sipas Rezolutës nr. 62/53, kishte shpronësuar 17.92 hektarë të tokës së pronarëve për të përfituar fondi bujqësor, si pronësi e përgjithshme kombëtare.
6. Më 12 shtator 1991, njëri prej të afërmeve të parashtruesit të ankesës kishte paraqitur një kërkesë tek Komisioni komunal i Prishtinës për kthimin e tokës në fjalë, bazuar në ligjin për kthimin e tokës të muajit mars 1991. Kërkesa ishte parashtruar kundër Ndërmarrjes shoqërore (NSh) "*Bujqësia dhe blegtoria*". Pasi parashtruesit e ankesës nuk e kishin pranuar propozimin e bërë nga NSh, procedurat kishin mbetur të pazgjidhura (shih paragrafin 8 më poshtë).
7. Toka e cila supozohet se është në pronësi të parashtruesit të ankesës më pas ishte përfshirë në procesin e privatizimit të NSh "*Lavertari - Blegtori*" e cila kishte dalë nga shpërbërja e një kooperative të madhe bujqësore "*Kosmet Export*" në vitet 1970-ta. Ofera e privatizimit për shitje ishte hapur nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) në valën e 6 të shitjes në vitin 2005. Toka përfundimisht i ishte shitur kompanisë "*Viktoria Invest*" në nëntor të vitit 2006.

Procedurat pranë DhVGjS

8. Më 16 maj 2008, parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga DVGjS që të bëhet kthimi i tokës në fjalë. Ai në kërkesën e tij kishte paraqitur se në procedurat pranë Komisionit komunal të Prishtinës në vitin 1992, i padituri - NSh "*Bujqësi dhe blegtori*" kishte propozuar që t'ia kthej 10 hektarët e shpronësuar të pronës së tij dhe 8 hektarë të pronës zëvendësimit. Parashtruesi i ankesës nuk e kishte pranuar këtë ofertë. Neni 9 i Ligjit për kthimin e pronës thotë se nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje gjatë procedurave në Komisionin komunal, atëherë rasti do të dorëzohet për procedim të mëtutjeshëm në një gjykatë të rregullt.

9. Më 30 qershor 2008, Departamenti i Kadastrës për pronësi të patundshme Prishtinë (Republika e Serbisë) kishte lëshuar një certifikatë që vërtetonte pronësinë fillestare të tokës në fjalë.
10. Më 27 maj 2009, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga AKP që ta përfshinte në privatizimi tokën në fjalë.
11. Më 1 shtator 2009, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar shfuqizimin e kontratës së privatizimit.
12. Më 27 janar 2010, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga DhVGjS që të lëshoj një urdhër paraprak për të ndaluar ndërtimin e ndërtesave të cilat kishin filluar të ndërtoheshin në tokën e cila kishte qenë në kontest në DhVGjS që prej majit 2008.
13. Më 1 shkurt 2010, DhVGjS kishte dërguar kërkesën për masën e përkohshme në AKP. Më 5 shkurt AKP kishte njoftuar DhVGjS se pronari i ri i tokës, i padituri në rastin e parashtruesit të ankesës NSh “*Bujqësi dhe blegtori*”, ishte në proces të likuidimit. AKP ka kërkuar që shqyrtimi i rastit të parashtruesit të ankesës të pezullohet.
14. Më 9 mars 2010, parashtruesit të ankesës i ishte kërkuar nga DhVGjS që të sqaroj nëse ai po kërkonte kthimin e tokës apo apelimin e procedurës së privatizimit, apo të dyjat, dhe të sqaroj kush ishin të paditurit dhe palët e treta në fjalë.
15. Më 25 mars 2010, parashtruesi i ankesa kishte kërkuar nga Agjencia Kadastrale Komunale e Prishtinës që të siguroj informata rreth pronësisë së tokës në fjalë.
16. Më 30 mars 2010, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga AKP, dhe nga pronari i disa parcelave të tokës në fjalë, të siguroj informata se kush e posedonte tokën.
17. Më 2 prill 2010, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga DhVGjS që të urdhëroj sigurimin e një informate të tillë, pasi ai nuk kishte marrë asnjë përgjigje për kërkesat e tij.
18. Më 22 prill 2010 DhVGjS kishte urdhëruar AKP që të siguroj brenda 14 ditësh informatat rreth pronarëve të rinj të tokës dhe dokumentacionin e bartjes së pronësisë së asaj prone.
19. Më 7 maj 2010, AKP ka njoftuar DhVGjS se toka ishte bartur tek kompania “*Viktoria Invest*” më 1 nëntor 2006. Për më tej, AKP ka njoftuar DhVGjS se më 28 prill 2010, kryetari i komunës së Prishtinës ka vendosur që për shkak të themelimit të komunës së re të Graçanicës, drejtorive komunale të Prishtinës iu ishte ndaluar të kryenin çfarëdo pune administrative që lidhet me komunën e Graçanicës, e cila nuk ishte ende në funksion. Si pasojë, nuk mund të ofrohej asnjë dokument zyrtar kadastral.

20. Me vendimin e datës 27 gusht 2010, DhVGjS kishte ftuar “Victoria Invest” që të merr pjesë si i pandehur i dytë në rastin të paraqitur në vitin 2008 nga parashtruesi i ankesës. Në të njëjtën kohë kërkesa e tij për masë e ndalimit iu hodh poshtë pasi parashtruesi i ankesës nuk kishte arritur të tregoj se ai do të pësonte humbje të pariparueshme.

Procedurat në Panelin e Apelit të DhVGjS

21. Më 20 shtator 2010, parashtruesi i ankesës kishte apeluar kundër vendimit që hidhte poshtë kërkesën e tij për një masë ndalim tek Paaneli i Apelit të DhVGjS. Ai kishte siguruar provë fotografike të ndërtimit që po vazhdonte në tokën e tij, e cila nëse përfundonte, do ta pengonte shfrytëzimin e kësaj toke për bujqësi.

Kërkesat për të përshpejtuar procedurat

22. Më 28 shkurt 2011, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar nga DhVGjS të përshpejtoj procedurat rreth bazueshmërisë së kërkesës së tij, si dhe rreth procedurave lidhur me apelimin e tij kundër refuzimi që të lëshohet një masë ndalese.

23. Procedura e apelit dhe procedura fillestare janë ende të pazgjidhura në panelet e DhVGjS.

Kontaktet me EULEX-in

24. Në ndërkohë, më 3 dhjetor 2009, parashtruesi i ankesës iu kishte afuar Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të RULEX-it duke i kërkuar asaj që të caktoj një seancë në procedurën që është e pazgjidhur në DhVGjS. Ai mori një përgjigje më 17 dhjetor 2009 që thoshte se kishte pasur vështirësi me gjendjen e stafit të DhVGjS.

25. Ai kishte përsëritur kërkesën e tij më 11 mars 2011.

Legjislacioni përkatës

26. Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kapitulli II, neni 2.1 thotë si më poshtë:

Gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë dhe përgjegjësi që të ushtrjnë funksionet për lëndët që janë në kuadër të juridiksionit të gjykatave ku ata janë caktuar nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX-i në KOSOVË.

III. ANKESAT

27. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj) 1950), dhe konkretisht shkelje sipas Nenit 6 të Konventës (e drejta për proces të rregullt, kohëzgjatja e procedurave); dhe Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës (mbrojtja e të drejtës së pronës).

28. Ai kërkon nga Paneli që të bëjë rekomandime për të zhvilluar shqyrtimin e rastit të tij para DhVGjS sa më shpejt që është e mundur.

IV. LIGJI

29. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.
30. Siç përcaktohet në Rregullën 25, paragrafi 1 i Rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
31. Sipas Rregullores së përmendur, dhe bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
32. Paneli vëren se parashtuesi i ankesës, në thelb, kërkon që Paneli të ndërmerr masa në mënyrë që të përshpejtoj procedurat në rastet e tij, të cilat janë të pazgjidhura pranë DhVGjS dhe pranë panelit të apelit të DhVGjS, institucione të Kosovës.
33. Paneli nuk ka kompetencë sa i përket fushave administrative apo juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rregullin dhe shpejtësinë, me të cilat ankesat e pazgjidhura janë duke u shqyrtuar nga DhVGjS. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues në DhVGj dhe në panelin e Apelit të DhVGjS, që janë të caktuar për ta shqyrtuar rastin, nuk ia mohon DhVGjS natyrën e saj, e cila është pjesë e sistemit juridik të Kosovës.
34. Si rezultat, çështja e ngritur në këtë ankesë nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, *gjen* se ankesa është e pabazuar sa i përket Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit